

Jorgo Bulo

RRETH NDIKIMIT TË FOLKLORIT NË VEPRËN E ÇAJUPIT

Për lidhjen e veprës së Çajupit me krijimtarinë popullore është folur dhe shkruar shumë. Problemi është prekur si në punime kushtuar krijimtarisë së poetit, ashtu edhe në artikuj të posaçëm. Megjithatë, mendojmë se ende ka çështje dhe aspekte të problemit, që mund të hetohen dhe të sqarohen më tej. Me këtë punim jemi përpjekur të vemë në pah disa elemente, që flasin për lidhjen e brendëshme të frymëzimit të poetit të shquar të Rilindjes me muzën popullore të Zagorisë.

* * *

Në studimet e gjertanishme për Çajupin, kur është prekur problemi i marrëdhënieve të veprës së tij me folklorin, ndikimi i poezisë gojore tek poeti është shikuar vetëm në disa vargje dhe figura të marra nga këngë të ndryshme lirike të Zagorisë apo të krahinave të tjera të jugut. Pa fjalë, se një kundrim i tillë e ka ngushtuar problemin: ndikimi i begatshëm dhe i shumanshëm i krijimtarisë artistike gojore është reduktuar kështu në disa konkordanca, që bijen në sy qysh në vështrim të parë, por që nuk e sqarojnë në mënyrë të plotë çështjen.

Për të sqaruar problemin që na intereson është e nevojshme të vëzhgohet lidhja e poetit me traditat popullore në përgjithësi, me jetën, zakonet dhe mentalitetin e popullit të krahinës së Zagorisë. Është thënë, se Çajupi i shkëputi lidhjet me fshatin e lindjes qysh në fëmëni dhe në pasojë të kësaj e harroi jetën që bënin bashkëfshatarët e vet. Bile është pohuar, se Çajupi nuk e dinte shqipen dhe filloi ta mësonte pas vitit 1898. Por faktet flasin ndryshe. Më 1898 ai botoi artikullin «Duke kërkuar një alfabet»¹, ku bie në sy njohja e thellë nga ana e tij e problemeve dhe e veçorive të gjuhës sonë. Me 1902 Çajupi botoi «Baba-Tomorrin», por s'ka dyshim, se hartimin e kësaj vepre ai do ta ketë nisur disa vite përpara, për të cilën dëshmon siguria dhe forma e përkryer e vargjeve, gjëra këto, që kërkojnë kohë dhe përvojë të gjatë. Duke u nisur nga këto fakte nuk mund të pranohet mendimi, se gjuhën e pasur me shprehje dhe figura të krahinës së Zagorisë e mësoi në Kajro. Është e vërtetë, se për kohën e fëmënisë dhe rinisë së hershme të poetit të dhënat janë të pakta. Por nga studimi i tyre i vemendshëm, del, se poeti nuk është larguar shumë herët nga fshati, siç mendohet nga disa. Sipas këtyre të dhënave, Çajupi kaloi në vendlindje jo pesë e as dhjetë vjet, por plot gjashtëmbëdhjetë vjet, e bile diçka më tepër. Ai iku nga Sheperi më 1887, kur kishte hyrë në periudhën e rinisë së pjekur, në moshën 22 vjeçare. Mund të supozojmë, se në këtë moshë ai njihte mirë zakonet e traditat e fshatit, që manifestoheshin në dasmat, të cilat zgjasnin një javë dhe në shumë çfaqje të jetës së popullit. Por edhe pasi shkoi jashtë, ai nuk i shkëputi lidhjet me

1) Shih Çajupi—Vepra, Tiranë 1957 f. 313-323.

vendlindjen. Siç dihet, çdo verë ai e kalonte në fshat dhe verën e fundit qëndroi aty plot tre muaj. I lidhur ngushtë me traditat e popullit, Çajupi që në fshat filloi të vjershërojë, duke ndjekur modelet e poezisë gojore. Zakonisht kurbetllinjë sheperjotë pas shumë vjet mërgimi, që u thithte shëndetin, ktheheshin në fshat të hanin ato pesë kacidhe që kishin fituar. Parmëndën e draprin s'e përdornin dot dhe ditën e kalonin duke lojtur letrat në dyqanin e Kagjinit². Më se një plak sheperjot mban mend, si poeti i ardhëshëm i vinte që atëhere në lojë këta kurbetllinj. Në sofatin e dyqanit të Kagjinit ai pat shkruar atëhere vargjet:

Shihni, shini, te Kagjini
Se si luetë skabili . . .

Dhe poshtë këtyre vargjeve vuri emërin «Andon Çako». Kështu pra, rrugën e vjershërimit Çajupi e zgjedh nën ndikimin e traditës popullore. Për ta përfytyruar qartë, si poetin e ri e tërhoqi poezia, duhet theksuar, se tradita e të shprehurit në vjershë qe, veçanërisht asi kohe, shumë e përhapur në Sheper. Aqë e vërtetë është kjo, sa që dhe të huajt që vinin nuk i shpëtonin kësaj tradite. N'atë kohë edhe më vonë në ato anë bënin kërdinë hajdutët. Tregojnë, se kur kapën disa prej tyre, përpara ekzekutimit, në një shesh mbi Sheper, duke iu përgjegjur kësaj tradite si dhe shpotitjeve të sheperjotëve, në vend të fjalës së fundit, ata i detyronin t'ia mirrnin këngës, me të cilën i linin lamtumirën kësaj bote:

Moj nëno ballë-behari,
Hapi gjethja, hapi bari
Për ty do më marrë malli . . .
Vritemi për sherr Barjami . . .
(Populli)³

Lidhja me traditën popullore ishte kaqë e fortë, sa u ruajt dhe la gjurmë të thella në personalitetin dhe jetën e poetit. Çajupi qe i muhabetit e i këngës labçe në çaste gëzimi e hidhërimi, këndonte bukur dhe ruante gjallë atë humorin e hollë fshatarak; zakonet e Zagorisë i pëlqenin dhe i pat respektuar ato edhe kur qe larg vendit, si na ka treguar miku i tij, Sofokli Capi.

Se sa i shtrenjtë ishte për Çajupin çdo kujtim i jetës së fshatit ku kishte kaluar çastet më të bukura të rinisë së tij, flet edhe pseudonimi që ai zgjodhi, kur hyri në botën e letrave shqipe. Në përfytyrimin e popullit të asaj krahine mali i Çajupit ishte, si të themi, selia e muzës popullore. Atje murmërijnë dy kroje me ujë të ftohtë e të shëndetshëm, heqin valle lulet, që diç i pëshpërisin në vesh njera tjetrës. Kështu paraqitet Çajupi në këngën e popullit. Këtë këngë e njohu dhe e këndoi Andon Çakua dhe në përfytyrimin e tij Çajupi u ngrit si në përfytyrimin e popullit, vend i një bukurie të rrallë poetike. Nuk është i rastit gjithashtu fakti, që të parin tregim që njohim prej tij e titullon «Mysafirët e Çajupit» dhe se në te ai përshkruan bukuritë e rralla të Çajupit, ku rri çeta e kapedan Gugës.

Të gjitha këto na çojnë në konkluzionin, se mbështetja e Çajupit në folklor përbën një parim të ndjekur me ndërgjegje prej autorit, parim

2) J. Bulo: *Çajupi në kujtimet e bashkëkohësve* Rev. «Ylli», Nr. 3, 1966.

3) Mbledhur nga autori i këtij studimi në Zagori.

nga i cili del se nuk është fjala për marrjen e ndonjë vargu apo figure, të shkëputur, siç paraqitet nëpër tekstet tona, por për një lidhje të bren-
dëshme të ngushtë me shpirtin e popullit të thjeshtë, me ndjenjat dhe
përfytyrimet e tij.

Edhe gjuha dialektale e përdorur prej Çajupit, lufta e tij kundër
purizmit (që është një meritë dhe s'duhet shikuar me keqardhje) janë
shprehje e lidhjes së tij me traditën popullore, e vlerësimit të lartë që
ai i bëri gjuhës popullore. Përpara rilindasve çasti historik shtroi si detyrë
të ngutshme ruajtjen e gjuhës si shenjë, luftën për pastrimin dhe pasu-
rimin e saj. Ashtu si për rilindasit e tjerë, për Çajupin «gjuha është një
element i fuqishëm, i domosdoshëm për ruajtjen e racës». «Gjuha shqipe
— shkruan ai — është e pamjaftueshme si gjuhë letrare dhe shkencore,
por ajo ka mbetur e kulluar, ekspresive». ⁴ Këto tipare, që jetonin në
gjuhën e popullit, duheshin, sipas tij, pohuar përmes veprash të shkruara.
Duke ndjekur këtë rrugë, Çajupi solli një kontribut të çmueshëm për pa-
surimin e shqipes me frazeologjinë e pasur popullore, me shprehje të
freskëta dhe të gjalla. Edhe në këtë anë duhet të shohim lidhjen e tij me
traditën popullore në përgjithësi.

Ajo që e dallon krijimtarinë e Çajupit nga shkrimtarët e tjerë të kohës
është realizmi. Çajupi i pari në letërsinë tonë nisi rrugën e realizmit,
sepse sipas mendimit tonë, ai u mbështet në mënyrë të plotë dhe të gjërë
në folklor. Dhe Mjeda eci në shtigjet e realizmit, por në pasqyrimin
realist të jetës popullore Çajupi arriti suksese të rëndësishme. Mjeda s'u
mbrujt me frymën e krijimtarisë popullore, sepse fëminia e rinia e tij,
ndryshe nga ajo e Çajupit, kaloi në qytete e nëpër shkolla jashtë. Ele-
mentet realiste të veprës së Mjedës qenë rezultat i kontaktit direkt me
jetën e mjeruar të popullit në periudhën e pjekurisë së tij, kontakt që,
siç dihet, Çajupi në këtë periudhë e mbajti përmes këngës, ku ruheshin
të gjalla hallet dhe brengat e popullit të thjeshtë. Pa dyshim, se jeta e
popullit, realiteti shqiptar, ka pjesën e vet në ngjizjen dhe forcimin e
realizmit të Çajupit; ai përbën burimin e parë; por ato mbresa të një
kohe të largët do të ishin zbehur, sikur të mos i kish mbajtur gjallë kënga
e popullit.

Kur shkroi:

	Shqipëtarët, si dhe bakëtia,
	Çbathur, çveshur, vdesën nga uria! ⁵
apo	O bo bo, sytë ç'më panë!
	Shkretëtirë, lum e det!
	Këtu gratë vetëm janë,
	Burrat gjenden në kurbet.
...	gra punojnë nëpër ara
...	Me ca petka vëra-vëra,
	me kokë poshtë të tëra, —
	ç'janë këto kafshë? — thashë. ⁶

poeti nuk u nis vetëm nga mbresat që mblodhi nga vëzhgimi i jetës po-
pullore, por u mbështet dhe në këngën popullore, ku flitet me forcë

4) Çajupi — *Vepra*, Tiranë 1957, f. 319-320.

5) Çajupi — *Vepra*, Tiranë 1957, f. 39.

6) *Po aty*, f. 297.

depërtonjëse për gjendjen e mjeruar të fshatarëve. Megjithëse robtisej në punë, zagorjotja nuk ka me se të gatuaq gjellën:

Qysh të bëj e varfëra
Dit për dit për lakëra. . .

sepse edhe për lakrat duhet vaj, por:

Për vaj nuk ka para
I thotë (burri — J.B.) gruas aman
Merr, shpjere këtë sahan;
Lëre rehem ndë dyqan. . . 7

Dhe për një pikë vaj gruaja e linte «rehem» sahanin ndoshta të vetmin sahan të shtëpisë. Këto vargje të poezisë popullore ne nuk i gjejmë as në poezinë «Baba Tomorri», as në poezinë «Fshati im» e as në «Baba-Musën lakuriq», por fryma e tyre, përshkon të gjithë veprën e Çajupit, të cilat u bënë jehonë rënkimeve, që mbushnin vargjet popullore.

Edhe vargjet e këngës popullore:

I ziu që kur kam lerë
Yzmeqar derë më derë
Me një këmishë të çjerrë. . . 8

nuk i gjejmë në ndonjë poezi të Çajupit, por frymën e tyre e diktojmë në dhjetra vargje të veprës së tij, bile dhe në poezinë «Kurbeti», ku poeti qan hallin e Mitros, që kaloi tërë jetën hyzmeqar «nënë urdhër», me «qesenë një kokë udhër».

Jeta e mjeruar e plot halle e popullit të Zagorisë gjeti pasqyrimin e vet artistik në këngët, që i përshkojnë notat e hidhërimit dhe të dhimbjes. Nevoja për të shprehur protestën ndaj këtij realiteti i dha folklorit, sidomos lirikës një frymë të theksuar realiste. Këtë element e mori dhe e zhvilloi më tej, Çajupi - poet. Brengat dhe privacionet në të cilat ishte kredhur jeta e fshatarëve të varfër të Zagorisë dhe sidomos e grave, së cilave iu binte bretku tërë ditën e ditës në punë, gjetën shprehje në këngët e shumta, ku kritikohet pozita e pabarabartë e gruas. Poeti popullor qan hallin e nuses, e cila, jo vetëm që s'ngre dot kryet nga punët e shumta që ka, por duhet t'u rrijë «qiri më këmbë» vjehrës, vjehrit, burrit e singjenisë:

Hënez'o sa dit'je zënë
Ku je sot ku jeshë prëmë?
— Jeshë tek e zeza mëmë.
— Lanet past'ajo jot'ëmë,
To tretesh, moj hardhj'e ngrënë
To tretesh qiri më këmbë. . .

Çajupi ka marrë prej këtyre këngëve mënyrën si e shikon populli pozitën e gruas dhe në këtë frymë e trajtoi këtë temë në disa prej krijimevet të tij më të mira.

7) A. Fico, *Kërkime folklorike në krahinën e Zagorisë*, «Buletin i U.Sh.T. Seria Shkencat Shoqërore 2, 1961, f.149.

8) Këngë popullore.

Në «Antologjinë e letërsinë shqipe» ku analizohet komedia «14 vjeç dhëndër» përmendet si shembull nga ku është frymëzuar Çajupi kënga «Çupë Radoneci — Martuar Radostinë...»⁹, që s'dëgjohet në Zagori, e zor ta ketë njohur Çajupi. Folklori i Zagorisë është i pasur me këngë, në të cilat vihet në lojë martesë me ndryshim të madh moshe, prandaj është e vështirë të pranohet mendimi, që Çajupi të ketë marrë shtysën për komedinë e vet nga kënga pogradecare. Për të vërtetur këtë po sjellim këto këngë që jetojnë edhe sot në Zagori:

Do ta lanetisë,
Nënëzën time,
Që më dha një burrë,
Cikë e një thërrime.
U vete në krua,
Ai vjen pas mua.
— Merrmë, o nëne, merrmë,
Kaçe mbi bucelë.
— Ç'nëne më ke mua
O lum, o përrua,
Mua mo më ke grua...¹⁰

Ose kënga:

Burri i vogël, moj, kërcure,
As e hidh në djep e tunde,
Unë e tunda motmot,
Në këmbë s'e ngrita dot...¹¹

Në komedinë «14 vjeç dhëndërr» gjejmë vargjet:

Dhëndërrri: Lozëm nonjë lodër?

Të dua si motër.

Nusja: Ç'motër më ke mua,

o lum'o përrua?

Ti më more grua¹²

Me gjithë afërinë e dukshme të vargjeve popullore me dialogun e sipërm nga vepra e shkrimtarit tonë të shquar, do ta thjeshtonin problemin po ta shihnim ndikimin e folklorit në krijimtarinë e poetit në ruajtjen e disa vargjeve. Pa dyshim, hyrja organike e motivit popullor në fakturën e veprës provon, se ai e njihte folklorin dhe se komedia është krejt në frymë popullore. Por rëndësi thelbësore ka fakti, se pozita që ai mban karshi kësaj plage shoqërore përputhet me atë të poetit anonim, i cili shpreh anët më të avancuara të mentalitetit të popullit punonjës. Në këtë rast duhet të themi, se idea organizuese e veprës «14 vjeç dhëndër» është pikërisht mënyra se si e çmon populli martesën me diferencë të madhe moshe. Përsa i përket pohimit, se «temën e komedisë «Katërbëdhjetë vjeç dhëndërr» e nxorri gjithashtu nga poezia popullore që i ka satirizuar shpesh martesat mes njerëzish me mosha fort të ndryshme»¹³, ne do të

9) «Antologji e let. shqipe», Tiranë, 1958, f. 508.

10) A. Fico: *Kërkime folklorike në krahinën e Zagorisë*, «Buletin i U.Sh.T. Seria Shk. Shoq.» 2, 1961, f. 141.

11) *Po aty*.

12) *Çajupi — Vepra*, Tiranë 1957, f. 132.

13) Dh.S. Shuteriqi: «Histori e let. shqipe për shkollat e mesme», Tiranë 1964, f. 130.

thoshim se ky është një teprim. Temën Çajupi e mori nga realiteti; poezia popullore i mprehu penën e ndjenjën, duke e bërë që të mbajë ndaj këtij fenomeni atë qëndrim, që mban populli në poezinë e tij.

Kurbeti qe një nga plagët më të rënda të vegjëlisë së këputur të Zagorisë. Çajupi e provoi vetë, por jo si e provoi Mitrua, me qesenë «një kokë udhër». I lidhur ngushtë me jetën dhe aspiratat e fshatarëve, që mirrin udhët për në vendet e huaja për të nxjerrë bukën e gojës, Çajupi i këndoi kurbetit ashtu siç i këndonte populli. Ja pra dhe në këtë rast ai huajti nga folklori mënyrën si i këndonte kurbetit varfanjaku, që linte shtëpinë, gruan, fëmijët dhe mirte udhën e hidhur të mërgimit. Kur analizojmë çështjen e mbështetjes së Çajupit në folklor, kjo ide duhet theksuar në mënyrë të veçantë se ka rëndësi të madhe. Në tekstin e «Historisë së letërsisë shqipe për shkollat e mesme» thuhet se temën e vjershës «Kurbeti» Çajupi e mori nga poezia popullore¹⁴. Mund të jetë kështu, mund të mos jetë kështu. Ai jetoi në kurbet dhe s'përjashtohet mundësia që realiteti i kurbetllinjve t'ia ketë sugjeruar këtë temë. Por krahas kësaj nuk mund të mos vihet në dukje, se njohja me poezinë popullore ka lojtur një rol të dorës së parë për të trajtuar këtë temë. Për të vërtetuar po sjellim disa shembuj, ku shihet si populli qante fatin e mjerë të kurbetllinjve:

Ç'ka bari që s'mbin në qafë?
Nga lotët që derdhin gratë.
Po ti vetëm korrke grurë,
ku e ke kërcunë burrë?
— Burri është në kurbet,
më la vetëm kaqë vjet... (Populli)

E paarritëshme për forcën përgjithësuese të mendimit dhe për fuqinë emocionale të figurës është kjo këngë:

Nga deti ç'më ngrinë sytë
Zun' e dridheshin gjemitë
Lanet paçinë floritë,
Që na dhanë ksenititë.
Mblidhi shok'e bëni benë
Të mos kaptojmë Përmenë,
Gjirokastr' e Tepelenë.

Të gëzojmë fëminë
Edhe gjithë sigjeninë. (Populli)

Mendimi që shpreh Çajupi në tregimin «Istori e një familje», se mërgimi s'ndodh vetëm nga varfëria, por dhe se qe bërë si modë nga dëshira për të renë dhe nga egoizmi i burrave, nuk është një zbulim i rastit. Merita e Çajupit është, se shprehu një mendim, që pasqyrohet në këngën e popullit, ku kurbetllinjët i quajnë «të liqë» dhe «sakatë» ata që mbeten në fshat:

«Ju të liq, e ju sakatë,
Amanet u lëmë gratë...»

(Populli)

14) Po aty.

Gruaja zagorite i këndonte kështu burrit apo djalit, që shkonte në kurbet:

Udh' e mbar' o kurbetlli,
Të shkelte këmba flori,
Të shkelte këmba ergjënt,
Që këtu e gjer në vënt'
Populli

Por ëndërrat s'dilnin kurrë, geseja mbetej «një kokërr udhër» dhe ndodhnin drama ,si ajo që jep Çajupi në vjershën e gjatë «Kurbeti». Pra, duke u mbështetur në folklor, Çajupi i këndoi kurbetit jo si pasunar, jo me një mall e nostalgji të venitur, por me po ato nota dhimbjeje e proteste, që i këndonte populli i varfër. Në vend që të lidhet vepra e poetit me qëndrimin e popullit të thjeshtë ndaj kurbetit, si ndaj një plage të madhe shoqërore, gjë që i përgjigjet së vërtetës, ndonjëherë është bërë përpjekje për ta shikuar vjershën «Kurbeti» si imitim i këngës popullore.

Është shkruar se vargjet:

Mitrua kur u martua
Ndënji një muaj me grua
Shtatë dit' e shtatë net
Bëri Mitrua në det. . .

«imitojnë vargje të njëjta të këngës popullore mbi Aga Ymerin»¹⁵. Një interpretim i tillë është i njëanshëm, se niset nga konkordancat e jashtme dhe jo nga lidhja e brendëshme e frymëzimit të poetit me aspiratat dhe dëshirat e popullit punonjës.

Po a ka në veprën e Çajupit vargje të ngjashme ose të njellojta me ato të këngëvet popullore? Po, ka. Dhe është një gjë e mirë të gjenden ato për të provuar, se si e ka pasuruar Çajupi gjuhën e poezisë sonë, duke shfrytëzuar folklorin. Le të përmendim vetëm disa.

Kudo shkela u tha bari!
Tani q'u poq molla e hanë të tjerë!
Moj Zolejkë, nga ke dalë,
Që ke diellin në ballë?

Do t'u bie me kobure
T'i lëshoj je shesh shondure.

Se gjer sa ka shporta fiq
Gjithë bota janë miq. .

Kaqë dita, kaqë thasë
Më të mirat ty t'i lashë. . .

Tym pa zjarr nukë ka kurrë
(«Baba Tomori»)

¹⁵) Dh.S. Shuteriqi: «Histori e let. shqipe për shkollat e mesme», Tiranë, 1964, f. 131.

Nga komedia «Katërmbëdhjetë vjeç dhëndërr»:

U hante koka për brirë.

Baban' e mirë nderoe
Dhe baban' e lik duroe

T'i rroj' e ta ketë!
i lumt' ajo dorë.
vëntë dhe kurorë...

Gati gjithë këngët e skenës së dasmës (pamje IV) janë të njëjta ose të ngjashme me ato të folklorit.

Nga vepra e pabotuar «Baba Musë Lakuriq»¹⁶ gjejmë këto elemente marrë hua nga folklori

Folmë, moj, në je kaure,
Në je kaure me besë,
Falu, burri yt të vdesë...

Rronin si këmbët e dhisë
Gjak në faqe nuk kanë
Dhe gjuha, kur zë e flet
Eshtra s'ka, po eshtra pret.

Të shkretatë këto vënde
Për ty për bukuri tënde.
Për e bukur s'kish më mirë:
Si dielli ndaj të gdhirë.

Ç'ke moj zëmër që rënkon?
Koka bën, koka pëson.

Moj lulez' e barit njomë
Në të bën zëmra qërtomë,

Po del në der' e shukomë,
Në je vetëmë dëftomë,
Mos ki frikë se na njonë,
Pa dhe me sy të na shonë
Nukë kanë ç'të na thonë
Se neve jemi gjitonë...¹⁷

Hallet e brengat e mia
S'i gjukon as perëndia.

16) Gjithë citimet nga «Baba Musa lakuriq» janë nxjerrë nga dorëshkrimi, që ruhet në Arkivin e Shtetit (Fondi A.Z.).

17) Krahaso me këngën popullore që jeton në Zagori:

«Lulez' e baritë njomë
del në penxhere vështromë ... etj.

Zoq e bilbilë këndon
Kur të gdhihet të na zgjoni... 18

Shokë ç'bënen nd'ata male
Nat' e ditë këng' e valle! 19

S'po përmendim këtu as «Burrin e dheut», as fabulat e përshtatura nga La Fonteni, as «Lulet e Hindit», as artikujt dhe shkrime të tjera të Çajupit, se lista me vargje, fraza e figura, që i ka populli dhe vepra e Çajupit, do të dilte shumë e gjatë. Po ç'provon kjo? Kjo tregon, se vepra e tij është e brumosur dhe e ushqyer me përfytyrimet, figurat dhe idetë e krijimtarisë poetike gojore. Sesa e vërtetë është kjo, këtë e provon fakti se vjershat e poetit u përvehtësuan nga fshatarët dhe bënë jetën e këngës Popullore. Vjersha e pabotuar «Lulja» u ruajt në gojën e popullit, në saje të kësaj afrie të ngushtë të poezisë së Çajupit me folklorin.

Një tipar tjetër i veprës së Çajupit është karakteri satirik. Ai fishkulloi jo vetëm zakonet prapanike, por dhe klerin, pasunarët, bejlerët dhe tradhëtarët. Poezinë e tij e përshkon humori i hollë fshatarak, ajo satira therese, që çquan poezinë popullore. Në Zagori jetojnë të gjalla këngët që satirizojnë priftërinjtë dhe demaskojnë moralin fetar. Ja si paraqiten në satirën popullore priftërinjtë imoralë:

O shok-o dy kushërira
T'i kesh u me dhën nga brinja,
T'i kesh-o unë fakiri
t'u xberthej komsat e gjirit
t'u sho gurt' e xhevairit»

(Populli)

Le të kujtojmë skenën e dasmës (pamje IV) në «Katërbëdhjetë vjeç dhëndër», ku me humor të hollë vihet në lojë prifti. Këtë frymë e gjejmë edhe në veprën «Baba-Musë Lakuriq»:

Po tani, patrikrit tanë
gjithë për besë mundohen;
nga të dashurat që kanë,
s'kanë kollaj të martonen...
... Tani punojnë për besë,
agjërojnë duke ngrënë,
grat i duan pa martesë...

Gjinia zotëruese e folklorit të Zagorisë është lirika. Edhe në lirikë muza e poetit piu në gurrën e freskët të poezisë popullore të krahinës së vet. Në vjershat e tija erotike gjejmë po ato koncepte e norma morale, që karakterizojnë jetën e popullit. Ai i këndon dashurisë së thjeshtë e

18) Krahaso me këngën popullore:

«Këndona, bilbil, këndona,
Në na zëntë gjumi, zgjona...» etj.

19) Krahaso me këngën popullore zagorite:

«Ç'bënet-o në ato male
Gjithë këng' e gjithë valle...» etj. ose:
«... Përtej-o në ato male
Bënet' e një darsm' e madhe...»

të pastër, që s'njeh paranë. Poeti do ta ketë miken përpara kur të korrë e kur të vjelë, ai do që ajo t'i sjellë bukë në stan dhe të këndojë me të gushë më gushë. Rakila me Jakobin në «Baba-Muse Lakuriq» kullosin tufën e dhënve dhe këndojnë. Poeti ndërhyt:

Nisi fyelli dhe bie,
O bobo, se ç'u ka hie.

Njeri tjetërinë vështrojnë,
Gojë për gojë këndojnë...

Dhe më poshtë:

... Po si Eva një s'ka dalë,
Kish një bukuri të rrallë:
Faqet e saj po shegë,
kurm'i hollë si një degë;
O bobo ç'qen ata dhëmbë,
Ato duar, ato këmbë;
Cullufetë mu te veshi,
Lesht e kokës te sheshi...
... E bardhë posi tëborë,
Me një trëndafil në dorë.

Në këto vargje ne ndeshim me konceptin e popullit për bukurinë e gruas. Po me këtë frymë ai i këndon bukurisë dhe dashurisë edhe në poezitë e tjera.

Poeti ka dëgjuar nënën shqiptare si i këndon ninullat e ëmbla mbi djep, ka parë kujdesin e saj gjer në vetmohim për foshnjen e vet. Ndaj në këngën 29 të veprës «Baba-Musë Lakuriq» Rebekën e pikturon si një nënë e grua shqiptare, që rrit e kon me pekule fëminë:

Shukon-je me djem ndë duar
Vete-vjen duke kënduar
Dhe i vë ndë djep të flënë,
Dhe tund djepnë duke thënë:
— Flini, flini biro, flini,
Natën me shëndet ta gdhini...
... Flini biro, të madhoni,
Si u dua të më doni.»

Është kjo një provë tjetër e lidhjes së ngushtë me traditën dhe krijimtarinë popullore. Falë kësaj lidhje vepra «Baba-Musë Lakuriq» me gjithë subjektin fetar, ka një theks të fortë realist. Në të përshkruhen zakone, paraqiten skena nga jeta fusharake shqiptare. Në poemë pihen dolli, hi-dhen pushkë ashtu siç ngjet në dasmat fshatare të Shqipërisë. Në dasmën e Rebekës piqen 500 deshë dhe si në Zagori burrat rrinë veç e gratë veç, duke kënduar po ato këngë, që këndon populli kur përcillet nusja:

Dhe duke uruar hanë
Gratë veç burrat mënjanë.

Shoqet e Rebekës kur niset nuse i këndojnë:

— Ku je nisur për të vatë,
Shelege, bejk' e çobanit?
Ku le jot'ëm e tyt'atë
Dhe gjithë shoqet e stanit...
... Manushaqe që mban erë;
Tani që lëshove lule,
të trashëgojnë të tjerë...

Rebeka përgjigjet:

— Ndëgjoni, shoqet e mia,
Diç t'u them diç t'u qaem:
Do të ndaem nga shtëpia
Nga njerzit e mij do ndaem!

Vajtimet na kujtojnë vajtimet e njohura popullore. Ja si e qajnë vajzat e Llotit nënën:

Të shkretatë këto vende,
Për ty, për bukuri tënde...
... Folna, moj mëmë, një fjalë,
Hap syt'e puthna ndë ballë

Ndonse flitet për një bot tjetër, edhe vallet janë shqiptare. Ja si e përshkruan poeti vallen e çifutes Sara, gruas së Patrikut:

Me ta këndoi dhe Sara
Dhe hoqi vallen përpara
Sa bukur u hodh në valle!
Kur fort e kur me ngadale,
Kur me shami, kur me bres,
Kur me sup e kur me mes,
Kur më tutje, më tëhu
kur mbi thoj e kur mbi gju!

* * *

Pra siç shihet më lart, ndikimi i folklorit në krijimtarinë e Çajupit u shpreh në radhë të parë me përmbajtjen në idetë, në frymën e saj. Elementet e prozodisë popullore, vargjet trokaike të përziera si në poezinë popullore, por, natyrisht, në mënyrë shumë më mjeshtërore, forma e ndërtimit të fabulavet e, veçanërisht, hyrja e tyre si e përrallavet tona, stili, — të gjitha këto janë shfytëzuar për të shprehur ndjenjat dhe koncepte, që shquajnë popullin. Vepra e Çajupit me përmbajtje e frymë popullore nuk mund të derdhej veç se në modelet e këngës popullore. Kjo shpjegon faktin, pse në poezinë e Çajupit ndjejmë filladin e këngëve të Zagorisë, atmosferën e shëndoshë dhe dashurinë e fortë për jetën, për gëzimet dhe endjet e saja, që zotëron në krijimet artistike të popullit të kësaj krahine.